



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

NJESIA E PROKURIMIT

Dibër, më 03.10.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: Ndertim i pallatit social Bashkia Diber 2023.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime ndërtimi për shtëpi strehimi (45211200-1).

VLERA E FONDIT LIMIT: 67.070.833 (Gjashtedhjetë e shtatë milion e shtatëdhjetë mijë e teteqind e tridhjetë e tre) leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Diber ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin e ofertes sipas Shtojcës 1;

d. Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit sipas Shtojcës 2;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (**2020,2021,2022**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë të percaktuara në aktmarreveshje.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është percaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Percaktimi i viteve të kërkuesit për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2020,2021,2022**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës ose lotit që prokurohet.

Kjo pike konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.3. Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitet 2020,2021,2022, dhe detyrimet e maturuara për vitin 2023 prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Shenim: Per kete pike 2.2.3 te mesiperme operoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*

ose

b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:
 1. Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me:
 2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 3. Situacionin përfundimtar të objektit;
 4. Aktin e kolaudimit;
 5. Çertifikaten e marrjes në dorëzim;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

- ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
 1. Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me:
 2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 3. Situacionin përfundimtar të objektit;
 4. Aktin e kolaudimit;
 5. Fatura tatimore te deklaruar sipas legjislacionit ne fuqi.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm,

ose dyfishi i vleres limit te kontrates qe prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndertim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

N.P-1 A (Punime gërmimi në tokë)

NP-2 C (Ndertime civile industriale)

N.P - 7 A (Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje).

N.P – 11 A (Ndertime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike).

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme.

N.S – 2 A (Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre)

N.S- 3 A (Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).

N.S- 4 A (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese).

N.S- 9 A (Punime strukturore special).

N.S - 12 A (Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit).

N.S- 14 A (Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV).

N.S – 18 A (Punime topogjeodezike).

- **sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI;**

Për operatorët e huaj të bëhet njëhësimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (*njëhësimin*) e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë kompetente të ngarkuar me ligj në Republikën e Shqipërisë.

2.3.2/1 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me liçensë lëshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (*Për grumbullim, ruajtje dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta*), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit bashkëngjitur në SPE si mëposhte:

- Per piken NP-1 A është e parashikuar në piken 1 të preventivit me emertimin punime dheu, ku vlera është nga 0-20 milion leke.
- Per piken NP-2 C është e parashikuar sipas vlerës së preventivit, ku vlera është nga 51-100 milion leke.
- Per piken NP-7 A është e parashikuar në preventiv në piken piken 3/1 Sistemimi me uje të pijshem, sistemi i shkarkimit të ujërave të ndotura , mbledhja e ujërave të bardha, ku vlera është nga 0-20 milion leke.
- Per piken NP-11 A është e parashikuar në piken 2/1 me emertimin Furnizim me energji të Godinave (Kabina elektrike), ku vlera është nga 0-20 milion leke.
- Per piken NS-2 A është e parashikuar në piken 3/1 me emertimin Pajisjet hidrosanitare,Ambienti teknik, etj. ku vlera është nga 0-20 milion leke.
- Per piken NS-3 A është e parashikuar në piken 4/1 Fv.ashensor, ku vlera është nga 0-20 milion leke.
- Per piken NS-4 A, është parashikuar në piken 1/3 të preventivit me emertimin Punime murature,1/5 punime suvatimi dhe veshje, ku vlera është nga 0-20 milion leke.
- Per piken NS-9 A, është e parashikuar në preventivin për punimet e themeleve të objektit që do të ndërtohet, ku vlera është nga 0-20 milion leke.
- Per piken NS-12 A, është e parashikuar në piken 3 të preventivit, punime hidrosanitare, ku vlera është nga 0-20 milion leke.
- Per piken NS-14 A, është e parashikuar në 2/2 Impjanti elektrik, ku vlera është nga 0-20 milion leke.
- Per piken NP-18 A, është e parashikuar në preventiv dhe projekt për të gjithë punimet topografike, ku vlera është nga 0-20 milion leke.
- Per III.2.B, është bazuar në projekt-preventivin në piken 3.158/a, për (Për grumbullim, ruajtje dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta) që operatori ekonomik të jetë si licensuar për trajtimin e mbetjeve inerte që do të behen gjatë zbatimit të punimeve.

2.3.3 Staf kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar për këto punime.

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

- | | |
|----------------------|---------|
| - Inxhinier Ndërtimi | 1 (një) |
| - Inxhinier Topograf | 1 (një) |

- Inxhinier Mekanik 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Gjeolog ose gjeoteknik 1 (një)
- Arkitekt 1 (një)

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të pakten periudhën **Oershor 2023 e në Vazhdim**. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune noteriaale (*e vlefshme*).

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

-Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kritereve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit.

-Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

b) Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë , si më poshtë :

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të pakten muajin e fundit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale(*e vlefshme*).

c) Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë staf teknik dhe punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë :

- Teknik Ndërtimi 1 (një)
- Hidraulikë 2 (dy)
- Elektricitë 2 (dy)
- Hekurkthyes 2 (dy)
- Karpentier 2 (dy)
- Saldator 1 (nje)
- Hidroizolues 2 (dy)
- Specialist gipsi 1 (një)
- Punonjës duro-alumini 1 (një)
- Muratorë 2 (dy)
- Suvatues 2 (dy)
- Bojaxhi 2 (dy)
- Shtrues pllakash 2 (dy)
- Mekanik 1 (një)
- Drejtues mjeti te pajisur me Leje drejtimi te kategorise C 2 (dy)
- Manovratorë të pajisur me Dëshmi të aftësisë profesionale (DAP) 1 (nje).

Per punonjesit e sipercituar kerkohet qe te figurojne ne listepagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit, dhe te disponojne (deshmi kualifikimi profesional/certifikate/diplome) te leshuar nga institucione (shtetore apo private) te licencuara/akredituara nga autoritetet pergjegjese shtetore, sipas ligjit nr. 15/2017 "Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.", Kontratë individuale (e vlefshme).

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbimëri i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

- Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklaratë nga (Administratori i shoqërisë), Përgjegjës Teknik të Kantierit, i cili do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Përgjegjësi Teknik i Kantierit, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".
- Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) punonjës i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë certifikatën si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
- Operatorët ekonomikë duhet kenë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) "Auditues energjie", bazuar në ligjin nr. 124/2015 "Për eficientë e energjisë", i ndryshuar, i cili duhet të jetë i pajisur me "Çertifikatë për Auditues Energjitik në ndertesa", lëshuar nga Agjencia per Eficencën e Energjisë.

d) Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar në stafin 1 (një) mjek të përgjithshëm, bazuar në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë" i ndryshuar.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e individuale të punës,
- diplomën universitare.
- licencën përkatëse për ushtrimin e profesionit.

Nëse OE nuk kanë në stafin e tyre persona përgjegjës me aftësi dhe kualifikimet e duhura lidhur me ceshtjet e shëndetit në punë (nëse nuk kanë mjek të punësuar) mund ti sigurojnë këto shërbime me anë marrëdhënieve kontraktore (të paraqitet kontrata e vlefshme, diploma universitare dhe licenca përkatëse për ushtrimin e profesionit) me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

e) Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) ekspert zjarrfikës të shoqëruar me certifikatë/dëshmi kualifikimi për ushtrimin e profesionit lëshuar nga PMNZH.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën individuale të punës;
 - certifikatë/dëshmi kualifikimi.
 - Te figuroje ne listepagesen e muajit te fundit te shoqerise.
- h) Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave").

i) Operatori ekonomik të ketë në stafin e tij 2 (dy) specialistë të çertifikuar për “Punime në lartësi”, të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë të pakten muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Për këtë pikë detyrimisht të paraqitet:

- kontratën individuale të punës;
- certifikatë/dëshmi kualifikimi.
- Te figuroje ne listepagesen e muajit te fundit te shoqerise.

Shenim: Per keten piken 2.3.3 te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat, volumnet e preventivit, dhe natyrën e punimeve me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punëtore të shtuar dhe me mjetet e kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate. Të gjithë drejtuesit teknik janë kërkuar të

disponohen nga operatorët ekonomik duke u bazuar dhe në pikat e licenses së zbatimit, dhe të gjithë zerave të preventivit të hartuar nga projektuesi.

- Është kërkuar minimuni 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, me qëllim menaxhimin e zbatimit të punimeve ndërtimore, analizimin e projektit pasi kemi të bëjmë me punime ndërtimi të gjermimeve, punime konstruktive dhe arkitektonike ku është e nevojshme suporti teknik i inxhinierit të ndërtimit dhe ndjekjen e ecurisë së punimeve në kantier.
- Është kërkuar minimuni 1 (një) Inxhinier elektrik , me qëllim menaxhimin e zbatimit të punimeve elektrike, analizimin e projektit pasi kemi të bëjmë me punimet elektrike (Furnizim me energji i godinave dhe impianti elektrik ku është e nevojshme suporti teknik i inxhinierit elektrik dhe ndjekjen e ecurisë së punimeve në kantier.
- Është kërkuar minimuni 1 (një) Inxhinier mekanik me qëllim menaxhimin e zbatimit të punimeve mekanike, analizimin e projektit pasi kemi të bëjmë me punime mekanike ,konkretisht punimet e ashensori, pajisjet e sistemit kundra zjarrit ku është e nevojshme suporti teknik i inxhinierit mekanik dhe ndjekjen e ecurisë së punimeve në kantier.
- Është kërkuar minimuni 1 (një) Inxhinier hidroteknik , me qëllim menaxhimin e zbatimit të punimeve hidroteknik analizimin e projektit pasi kemi të bëjmë me sistemin e shkarkimit të ujrave të ndotura, mbledhja e ujrave të bardha ku është e nevojshme suporti teknik i inxhinierit hidroteknik dhe ndjekjen e ecurisë së punimeve në kantier.
- Është kërkuar minimuni 1 (një) Inxhinier topograf , pasi do të kryejë azhornimin topografik dhe piketimin e objektit ku do të llogariten edhe punimet e tjera sipas terrenit si dhe do të ndjekë punimet e zbatimit sipas kuotave të projektit. Gjithashtu pas përfundimit të punimeve do të bëjë edhe azhornimin faktit (as built).
- Është kërkuar minimuni 1 (një) Inxhinier gjeolog ose gjeoteknik , pasi referuar projekt-preventivit të këtij investimi kemi punime gjermimi për themelet ku inxhinieri gjeolog është i nevojshëm për përcaktimin kategorisë së dherave dhe formacionin tokësor në të cilat mund të kryhen këto punime me qëllim mbajtjen e peshës së objektit.
- Është kërkuar minimuni 1 (një) Arkitekt, pasi referuar projekt-preventivit të këtij investimi kemi të bëjmë me arkitekturën e objektit duke qenë se është dhe objekt banimi.
- Inxhinierët e stafit mbështetës,(ndërtimi,gjeodet,elektrik), ky prokurim ka për qëllim ndërtimin e objektit (ndërtim i ri) dhe ka punime të konsiderueshme në ndërtim,topografi (piketim) dhe punime elektrike, ku është e nevojshme që punimet të zbatohen dhe kontrollohen në mënyrë konkrete nga ana e inxhinierëve.
- Për pikën 2.3.3/c,d,e,h,i, të DT, janë kërkuar në përputhje me zerat dhe natyrën e punimeve të projekt-preventivit, duke filluar nga Punimet konstruktive dhe arkitektonike,punime betoni,beton arme,punime murature,punime terrace dhe hidroizolimi,punime shtresash,punime suvatimi dhe veshje,punime dritare,punime të ndryshme,punime bojatisje,punime elektrike,sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm,sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit,sistemi i shkarkimit të ujrave të ndotura,sistemi i ajrimit të kuzhinave dhe nyjeve sanitare,mbledhja e ujrave të bardha,punimet e

ashesorit, pajisjet dhe sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit. Kërkohej e gjithë kjo fuqi punetore në përputhje me të gjithë natyrën dhe zërat e preventivit duke u bazuar në grafikun e punimeve me qëllim që punimet të kryhen sa më korrekt dhe brenda afatit të parashikuar në dokumentat e tenderit.

- Në lidhje me kërkesën për disponimin si pjesë të stafit të punësuar 1 (një) *“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”*, njësi e prokurimit vlerëson se, kjo kërkesë është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi ky inxhinier ose punonjes i çertifikuar nevojitet për përshtatjen e kantierit sipas fazave të punimeve, mbajtjen e kantierit në kushte të rregullta, kontrollin e materialeve dhe pajisjeve të punës me qëllim eliminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë dhe/ ose shëndetin e punëmarrësve, si dhe verifikimin e zbatimit të planit të sigurisë dhe koordinimit gjatë zbatimit të punimeve kërkesa kjo në zbatim të nenit 9 dhe 10 të ligjit të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”*, dhe nenit 2, 5 dhe 10 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 *“Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”*.
- Në lidhje me kërkesën për disponimin e 1 (një) Ekspert zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, të pajisur me çertifikatën përkatëse lëshuar nga PMNZH njësi e prokurimit vlerëson se, kjo kërkesë është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi stafi operacional i operatorit ekonomik duhet të jetë i trajnuar për çdo rast emergjence, ku ndër to janë edhe rastet e zjarrit, kërkesë kjo bazuar në parashikimet e nenit 38 të Ligjit Nr. 152/2015 *“Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”*, në të cilin përcaktohet se, personat fizikë dhe juridikë zbatojnë dispozitat e parashikuara nga ky ligj dhe akte të tjera nënligjore, në lidhje me marrjen e masave për parandalimin e pakësimit të zjarreve, me anë të mjeteve, sistemeve, pajisjeve të diktimit-sinjalizimit për shuarjen e zjarreve, gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre.
- Në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e operatorit ekonomik në stafin e tij, të paktën 2 (dy) punonjës të specializuar dhe çertifikuar për punime në lartësi, njësi e prokurimit vlerëson se kjo kërkesë është e domosdoshme, duke qënë se bazuar në preventivin e punimeve kemi të bëjmë me kryerje të punimeve në lartësi (mbi 2 m) për ndërtimin e objektit i cili është 6 kate, kërkesë kjo në zbatim të përcaktimeve të nenit 11 të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”*, dhe pikës 13 të Aneksit V/ Seksioni II/ Pjesa B e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 *“Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”*, ku për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të paraqesë kontratat e punës (të vlefshme), dhe Çertifikatat përkatëse të punonjësve që do të angazhohen për kryerjen e këtyre punimeve.
- Po ashtu, me qëllim ndërtimin e objekt kontratës sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, duke qënë se vlera e preventivuar për punimet që do të kryhen është mbi 30,000,000 milion, në zbatim të Udhëzimit Nr.2, datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”* njësi e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në

licensimin e shoqërisë, si dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, kjo dhe në rastin kur ofertuesi merr pjesë si bashkim i operatorëve ekonomik, secili anëtar duhet të përcaktojë/ deklarojë drejtuesin teknik të punimeve, si dhe të paraqesë dokumentacionin e kërkuar.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet te kete fuqi minimale punetore te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit, me nje numer prej mesatarisht **50 (Pesedhete) punonjës.**

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Qershor 2023 – e ne vazhdim.**
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Qershor 2022 – e ne vazhdim.**

Shenim: Per kete pike 2.3.4 te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:Vendosja e ketij kriteri per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlllogaritur ne nje kohe te shkurter i cili kerkon fuqi punetore te shtuar dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate, ndërsa në lidhje me periudhën e kërkuar, për të paktën 3 muajt e fundit, njësia e prokurimit në hartimin e këtij kriteri iu është referuar datës së publikimit dhe zhvillimit të kësaj procedure prokurimi, **ku ka vlerësuar të nevojshme që për vërtetimin e bindjes se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një qëndrueshmëri dhe besueshmëri në fuqinë punëtore që realisht disponon**, ka kërkuar që ky punësim të disponohet deri në 3 (tre) muaj përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit, kërkesë e cila është e arsyeshme, proporcionale dhe aspak diskriminuese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punetore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punetore të shtuar dhe me mjetet e kerkuara për zbatimin me sukses të kesaj kontrate.

2.3.5 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- Certifikatë **ISO 9001:2015** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkepunimit
- Certifikatë **ISO 45001 - 2018** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkepunimit
- Certifikatë **PAS 99:2012** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkepunimit
- Certifikatë **ISO 27001:2013** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkepunimit
- Certifikatë **ISO 3834 -2:2006** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkepunimit

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

- *Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes*

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin

e Rregullave të Prokurimit Publik”. Certifikata e mesiperme jane kerkuar ne konform dhe ne propocion me natyren e punimeve qe do te kryhen per zbatimin e punimeve.

2.3.7 Operatoret ekonomik duhet te paraqesin mjetet dhe pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshte (shtojces 8):

Nr .	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Gjendja
1	Eskavator me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
2	Fadrome me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
3	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 8-ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
4	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 12-ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
5	Kamioncinë me kapacitet mbajtes deri në 3.5 ton - 5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
6	Kamioncinë me kapacitet mbajtes deri në 3.5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
7	Autobetoniere	2 copë	Në pronësi ose me qera
8	Autopompe betoni	1 copë	Në pronësi ose me qera
9	Betoniere kantier	1 copë	Në pronësi ose me qera
10	Autovinc me kapacitet mbajtes ≥ 8 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
10	Elektrobanko per kthim hekuri	1 copë	Në pronësi ose me qera
11	Skeleri fasade	1200 m ²	Në pronësi ose me qera
12	Pompë suvatimi	2 copë	Në pronësi ose me qera
13	Pompe shtresa betoni	1 copë	Në pronësi ose me qera
14	Autovinc me kosh	1 copë	Në pronësi ose me qera
15	Saldatrice	1 cope	Në pronësi ose me qera
16	Gjenerator ≥ 10 kVA	1 copë	Në pronësi ose me qera
17	Autobot uji	2 copë	Në pronësi ose me qera
18	Depozite uji ≥ 5000 litra	2 copë	Në pronësi ose me qera

19	Matrapik	2 copë	Në pronësi ose me qera
20	Vinc karel (portativ) i levizshem me kapacitet 0.3 - 0.5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
21	Vibrator betoni	2 copë	Në pronësi ose me qera
22	Kontenier stacionar/zyre e levizshme	1 copë	Në pronësi ose me qera
23	Vinc kulle me lartësi minimale 30 m	1 copë	Në pronësi ose me qera
24	Kanellë hidroizolimi profesionale e kompletuar	1 copë	Në pronësi ose me qera
25	Karroca dore	5 copë	Në pronësi ose me qera
26	Fabrike Inertesh e pajisur me Licencen III.1.B	1 copë	Në pronësi ose me qera ose kontratë furnizimi
27	Fabrike Betoni e pajisur me Licencen III.1.B	1 copë	Në pronësi ose me qera ose kontratë furnizimi

Operatorët ekonomik që disponojnë kontratë furnizimi për Fabrike betoni dhe Nyje thyerje materiale inerte, leja mjedisore u kërkojnë personave të tretë, që nuk janë konkurrent në këtë procedurë prokurimi.

Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronësi ose me qera), të nevojshme për ekzekutimin e kontratës si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):

- Kokore, minimumi 50 copë.
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 5 copë.
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi, 3 copë.
- Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 5 copë.
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi, 5 copë.

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikatën e pronësisë së mjetit.

b) Për mjetet e siguruar me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikatën e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse materiale të qerases, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

c) Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

- d) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- f) Makinat e transportit të shoqerohen gjithashtu edhe me Leje të Transportit të Mallrave (të vlefshme), lëshuar nga organet kompetente në emer të shoqerisë apo subjektit pronar të mjetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Shenim: Per kete pike 2.3.7 te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialisti i fushës.

Njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë automjetet, mjetet dhe pajisjet e kërkuara me anë të cilave do të kryhet punimet dhe transporti i materialeve sipas zerave të punimeve të përcaktuara në preventivin e specifikimit teknike objekt kontrate, ku sasia e tyre është kërkuar në përpjestim me natyrën e përmasat e këtyre punimeve, ku një operator ekonomik pa këto mjete e pajisje nuk mund t'i realizojë këto punimeve. Gjithashtu në zbatim të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e Rregullores "Për Sigurinë në Kantier", njësia e prokurimit ka kërkuar që operatorët ekonomikë duhet të disponojnë dhe pajisjet mbrojtëse për punonjësit të cilët do të angazhohen për kryerjen e punimeve objekt kontrate. Njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentacionin e nevojshëm që

duhet të paraqesin operatorët ekonomik pjesëmarrës me qëllim vërtetimin e disponimit të tyre, dhe dokumentacionin tekniko-ligjor për automjetet të cilat duhet të regjistrohen në regjistrat publik për qarkullimin e tyre.

2.3.7. Grafiku i punimeve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga projektuesi, bashkëngjitur DST ne SPE.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

NJESIA E PROKURIMIT: